



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore**  
**KRYETARI**

Rruga "Abdi Toptani", Nr. 1, [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al). E-mail: [klsh@klsh.org.al](mailto:klsh@klsh.org.al)

Nr.1265/6 Prot.

Tiranë, më 06/04/2018

**V E N D I M**

**Nr.23, Datë 06/04/ 2018**

**PËR**

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË MINISTRINË E BRENDSHME, TIRANË ME OBJEKT: " AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE", PËR PERIU DHËN 01.01.2015 DERI MË DATËN 31.12.2017.**

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Brendshme, me objekt "Auditim Përputhshmërie", për periudhën 01.01.2015 deri në 31.12.2017, u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësishme materiale për të cilën japim opinion të kualifikuar. Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

**V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në Ministrinë e Brendshme me objekt "Auditim Përputhshmërie", për periudhën nga data 01.01.2015 deri më datën 31.12.2017.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

**A. OPINIONI I AUDITIMIT**

Baza për opinionin mbi përputhshmërinë (ISSAI 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë") e veprimtarisë së Ministrisë së Brendshme.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti-Ministria e Brendshme, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të

përputhshmërisë), u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, të cilat konsistojnë:

- Ministria e Brendshme, për shërbimin e kryer në zbatim të kontratës për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Regjistratit Kombëtar të Gjendjes Civile ka paguar subjektin “X. S. A” Austri, direkt në llogarinë e tij në Austri në vlerën rreth 258,244 mijë lekë, pa TVSH dhe njëkohësisht ka paguar për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve vlerën e TVSH rreth 51,648 mijë lekë, veprim i cili ka sjell shmangien e tatimit në burim nga ky subjekt dhe mos derdhjen e tij në buxhetin e shtetit, në vlerën rreth 38,244 mijë lekë.

- Në buxhetin e vitit 2016 të MB, në programin e “Emergjencave Civile”, janë planifikuar 42,273,000 lekë. Ky fond është shpenzuar në rreth 41,862 mijë lekë, për pagimin e shoqërisë “V.H” (“A. & V. I.”) e kontraktuar pa procedura prokurimi për kryerjen e shërbimit ajror të fikjes së zjarreve që kanë rënë në territorin e vendit në muajin gusht-shtator të këtij viti. Gjatë kryerjes së shërbimit, u konstatua shkelje ligjore, me pasojë rritje të kostos së shërbimit në dëm të buxhetit të shtetit në vlerën 48,739 Euro ose rreth 7,976 mijë lekë. Po kështu edhe në buxhetin e vitit 2017, të MB, në këtë program janë planifikuar 29,000 mijë lekë. Ky fond është shpenzuar në shumën 27,318 mijë lekë, përsëri për pagimin e shoqërisë “V H” (“A.& V.I.”) e kontraktuar edhe këtë herë pa procedura prokurimi, për kryerjen e shërbimit ajror të fikjes së zjarreve që kanë rënë në muajit korrik-gusht të këtij viti. Për realizimin e këtij shërbimi janë marrë angazhime financiare në vlerën rreth 101,108 mijë lekë për të cilat nuk janë fonde disponibel të planifikuara në buxhetin Ministrisë apo të premtuara nga Këshilli i Ministrave për tu financuar nga buxheti i shtetit, si dhe gjatë kryerjes së shërbimit, u konstatua shkelje ligjore, me pasojë rritje të kostos së këtij shërbimi në vlerën rreth 45,000 mijë lekë.

- Gjatë zbatimit të punimeve për “Restaurim i Godinës së Ministrisë së Punëve të Brendshme”, u konstatuan punë të pakryera dhe të paguara, duke i shkaktuar buxhetit të shteti dëm ekonomik në vlerën rreth 1,122 mijë lekë, si dhe përdormi pa efektivitet dhe pa ekonomicitet të fondeve buxhetore në vlerën rreth 20,495 mijë lekë.

**Opinion:** Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 400, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Ministria e Brendshme u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësishme materiale për të cilat japim opinion të kualifikuar.

## **B. MASA ORGANIZATIVE:**

**1. Gjetje:** MB, gjatë periudhës objekt auditimi, në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, ka paguar nga buxheti pagat e 23 ish-punonjësve të larguar padrejtësisht nga puna në vlerën totale 34,640,603 lekë, respektivisht: në vitin 2015 janë paguar 4 punonjësve në shumën 9,674,561 lekë, në vitin 2016 janë paguar 10 punonjësve në shumën 8,874,330 lekë dhe në vitin 2017 janë paguar 9 punonjës në shumën 16,091,712 lekë. Edhe pse këto vendime gjyqësore kanë qenë të formës së prerë, pothuajse të gjitha pagesat nuk janë kryer vullnetarisht, por janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga përmbaruesit privat. Për këta përmbarues janë paguar nga buxheti i shtetit përveç pagave në shumën 34,640,603 lekë, edhe tarifatat e shërbimeve përmbarimore në shumën 647,340 lekë, duke rënduar kështu, koston buxhetore në dëm të buxhetit.

Gjithashtu, bashkëlidhur urdhër shpenzimeve, për likuidimin e shpenzimeve përmbarimore në favor të përmbaruesve private nuk janë bashkëlidhur faturat tatimore. Ky veprim është në kundërshtim me udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” ku përcaktohet se, “Njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë të detyruara të

*procedojnë me kryerjen e pagesës për mbylljen e detyrimeve menjëherë pas marrjes së faturës tatimore nga furnitori dhe të vërtetuar me kryerjen e shërbimit”.*  
*(Më hollësisht trajtuar në pikën në pikën 2, faqe8-12 dhe pikën në 3 faqe 14-16, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

### **1.1. Rekomandimi:**

Në çdo rast, me marrjen dijani për vendimeve gjyqësore të formës së prerë në favor të ish-punonjësve të larguar padrejtësisht nga puna, ekzekutimi i tyre të bëhet vullnetarisht, për të eliminuar shpenzimet përbarimore në dëm të buxhetit.

Afati për zbatimin e rekomandimit

*Në vijimësi*

### **1.2. Rekomandimi:**

Për çdo rast, kryerja e pagesave për mbylljen e detyrimeve ndaj përbaruesve të bëhet pas marrjes së faturës tatimore.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

*Në vijimësi*

**2. Gjetje:** Në zbatim të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe Urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratë shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, MPB ka krijuar bazën e të dhënave si dhe, me vendimin nr. 8652 datë 23.11.2015, ka ngritur Komisionin e Posaçëm “Për shqyrtimin e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë për menaxhimi apo rikthimin në një pozicion tjetër të shërbimit civil të ish-punonjësit të MPB të larguar nga puna”. Ky komision me cilësinë e organit kolegjal për çdo vit ka marr në shqyrtim të gjitha faktet dhe rrethanat e lindura për ekzekutimin e vendimeve për punonjësit e larguar padrejtësisht nga puna. Pas kësaj, ka njoftuar këta punonjës për rikthimin në punë në MPB apo në institucionet të varësisë në ato vende vakante ose ekuivalente me pozicionet e mëparshëm. Njëkohësisht, për çdo rast të rikthimeve në punë ka kërkuar dhe ka marrë miratimin e DAP. Nga shqyrtimi i procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e fundit të datës 05.09.2017 del se, nga 11 ish-punonjës komisioni i ka propozuar DAP për të miratuar rikthimin në punë për 10 prej tyre, ndërsa për ish-Drejtorin e Arkivit të MPB, z. K D ka arsyetuar se: “Pasi janë shqyrtuar të gjitha mundësitë për sistemimin në një pozicion të rregullt, ku të përputhet me kriteret e posaçme të një vendi vakant, të nivelit drejtor drejtorie në aparat apo në institucion varësie, ka rezultuar se pozicioni vakant në nivel drejtor drejtorie me kategorinë II-b bazuar në përshkrimin e punës nuk përputhet me arsimimin dhe eksperiencën e z. D. Mirëpo, ky arsyetim i Komisionit të Posaçëm nuk përputhet me arsyetimin e vendimi nr. 1965 datë 15.04.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i lënë në fuqi me vendimin nr. 1132 datë 16.03.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, sepse gjykata ka marrë vendimin: **“Për kthimin në detyrë dhe pagesën e pagës që nga momenti i largimit padrejtësisht nga puna të z. K.D”**.”

Pra, gjykata ka vendosur rikthimin e tij në punë dhe pagesën deri në datën e kthimit, ndërsa MB nuk e ka zbatuar tërësisht këtë vendim por, e ka zbatuar pjesërisht sepse, z. K.D me urdhër shpenzimi nr. 517, datë 28.12.2017 është paguar në shumën 3,001,114 lekë, për periudhën nga data e largimit nga puna 11.11.2014 deri në datë 31.10.2017. Por deri në përfundimin e këtij auditimi nuk i është ofruar rikthimin në punë në pozicionin e mëparshëm apo ekuivalent me këtë pozicion”.

Sa sipër, në zbatim të vendimit të gjykatës, z. D i lind e drejta ligjore që të përfitojë pagën në vazhdimësi, deri në rikthimin në punë nga MB. **Me qëllim, eliminimin e pagesave të tepërta**

**në dëm të buxhetit të shteti, MB në respekt dhe në zbatim të plotë të vendimit të gjykatës, duhet të marrë masa për rikthimin në punë në pozicionin e mëparshëm të z.K.D.. Po kështu duhet të veprojë edhe për të gjithë punonjësit e tjerët të cilët kanë marrë nga gjykatat të njëjtat vendime, për pagesën deri në rikthimin në punë të tyre.**

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe8-12, të Raportit Përfundimtar të Auditmit)*

## **2. Rekomandimi:**

Ministria e Brendshme, të marrë masat e duhura për zbatimin e vendimeve të gjykatës për rikthimin në punë të ish-Drejtorit të Arkivit z. K.D dhe të gjithë ish-punonjësve, si dhe të paguajë detyrimet ndaj tyre deri në momentin e kthimit në punë në pozicionin e mëparshëm.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

***Menjëherë***

**3. Gjetje.** Me mandat pagesën nr. 5 datë 24.03.2015 janë paguar shpenzime për udhëtim e dieta për shërbim pune në Bruksel, Belgjikë në datat 19-21 mars 2015 në shumën 865 Euro, respektivisht 425 euro për Zëvendës/Ministren znj. E. Gj. dhe 440 Euro për Drejtoren e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Integrimi znj. E. Z Në kundërshtim të VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” këta punonjës kanë përfituar padrejtësisht edhe shpenzimet për vaktin e mëngjesit në shumën 81 Euro, respektivisht nga 40.5 Euro secila. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 14-16, të Raportit Përfundimtar të Auditmit)*

## **3.Rekomandim:**

Në çdo rast, të trajtimit financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit, të mos paguhet shpenzimet ekstra për vaktet e mëngjesit, mbi normativen e përcaktuar në VKM nr. 870, datë 14.12.2011, si dhe të ndiqen procedurat administrative për kthimin e 81 Eurove në arkën e MB, të përfituar padrejtësisht nga punonjësit e sipërpërmendur.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

***Menjëherë***

**4. Gjetje.** Në të gjitha praktikatat e shpenzimeve për udhëtime dieta, mungon ftesa e vendit organizator pritës si dhe draft agjenda e punimeve. Me këto dokumente, vërtetohet qëllimi dhe objekti i shërbimit si dhe pjesa e shpenzimeve që do të mbulojë organizatori dhe pjesa që do të mbulojë buxheti i shtetit. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, dhe Udhëzimin nr. 22, date 10.07.2013 të Ministrisë së Financave. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 14-16, të Raportit Përfundimtar të Auditmit)*

## **4. Rekomandimi:**

Në të gjitha praktikatat për udhëtime dieta për jashtë shtetit, dokumentit të pagesave ti bashkëngjitet ftesa e vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

***Në vijimësi***

**5. Gjetje.** Në disa raste, punonjës udhëtues, kanë tërhequr vetë dhe kanë paguar me lekë në dorë biletën e avionit, në kundërshtim me procedurën e mini-konkurrimit brenda marrëveshjes kuadër për “ Blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar” dhe VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 14-16, të Raportit Përfundimtar të Auditmit)*

### **5.Rekomandimi:**

Në të gjitha praktikat për udhëtime jashtë shtetit, biletat e avionit të blihen sipas procedurës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

*Në vijimësi*

**6. Gjetje.** Gjate vitit 2015, 2016 dhe 2017, MB në 11 raste ka marrë nga shoqëria “G” SH.P.K, sallave me qira në H T, për organizime eventesh të ndryshme si, trajnime e konferenca, Workshope etj. Konkretisht: gjatë vitit 2015, ka marrë në 5 raste me vlerë totale 2,6769,980 lekë , gjate vitit 2016 ka marrë në 3 raste me vlerë totale 411,030 dhe gjatë vitit 2017 ka marrë në 3 raste me vlerë totale 903,160 lekë

Në të gjitha këto raste marrje me qira e sallave është bërë pa procedura prokurimi në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, me VKM nr. 914, datë 29/12/2006 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar dhe me Udhëzimin e APP nr. 3, datë 27.01.2015,"Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, sepse për këtë shërbim nuk janë kryer procedura prokurimi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 17-18, të Raportit Përfundimtar të Auditmit).*

### **6. Rekomandimi:**

Për të gjitha raste e shërbimit të marrjes me qira të ambienteve për organizime të ndryshme për nevoja të MB, të kontraktohen sipas rregullave te prokurimit publik

Afati për zbatimin e rekomandimit:

*Në vijimësi*

**7. Gjetje.** Për vitin 2015, nuk është kryer inventarizimi fizik i gjendjes së aktiveve dhe inventari në përdorim, në kundërshtim me pikën 85/a të UMF nr. 30, datë 27.12.2011. Ndërsa për vitin 2016, inventari fizik i gjendjes së aktiveve dhe inventari në përdorim është kryer por, komisioni nuk ka përpiluar një raport për vlerësimin paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së aktiveve, si dhe nuk ka realizuar verifikimin në vend të të gjithë aktiveve që janë në përdorim dhe ngarkim të personeli, në kundërshtim me, Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 22-23, të Raportit Përfundimtar të Auditmit)*

### **7. Rekomandimi:**

Të kryhet inventarizimi duke bërë verifikimin në vend për të gjithë vlerat materiale që janë në përdorim dhe ngarkim të personelit. Pas këtij inventarizimi nëse dalim diferenca në shtesa apo mungesa të vlerave materiale të behet sistemimet përkatëse në kontabilitet.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

*Brenda muajit qershor 2018*

**8. Gjetje.** Nga verifikimit fizik i magazinës u konstatua se, janë gjendje disa pajisje kompjuterike, laptop, fotokopje, skaner fax, projektor,etj., të regjistruara me koston historike në shumën prej 10,420,981 lekë, por si rezultat i amortizimi dhe defekteve janë bërë të papërdorshme. Nga komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të ngritur, për këto pajisje nuk është mbajtur një procesverbal nëse këto pajisje duhet të dalin jashtë përdorimi, pasi të kenë vlerësuar anën teknike, funksionale dhe mos mundësinë e rinovimit të tyre, në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 22-23,, të Raportit Përfundimtar të Auditmit)*

## **8. Rekomandimi:**

Të ngrihet një grup pune me përbërje specialist të fushës, për të bërë verifikimin në vend të të gjithë pajisjet gjendje në magazinë të pa përdorura, për të vlerësuar nëse këto pajisje kanë vlerë përdorimi apo duhet të dalin jashtë përdorimi.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

*Në vijimësi*

**9. Gjetja:** Sipas pasqyrave financiare (bilanci) përmbledhëse për të gjithë njësi vartëse, në fund të vitit 2016, gjendja debitorë (klasa 4) paraqitet në vlerën 8,318,301,000 lekë nga e cila një pjesë e konsiderueshme paraqiten edhe pa shpresë arkëtimi, sepse është krijuar dhe e trashëguar që nga trazirat e vitit 1997-1998, apo me përpara. Për aparatën e MB, shqetësuese mbetet mos arkëtimi i shumës 27,365,134 lekë nga debitori z. E. A. Ky detyrim është krijuar para vitit 2000, për shkak të abuzimeve të bëra në tenderin e prodhimit të pasaportave për jashtë shtetit. Ndërsa shqetësuese mbeten edhe debitorët në njësitë vartëse si:

-Në Gardën e Republikës paraqiten debitorë në shumën 30,325,039 lekë, ku pjesën më të lartë e zënë debitorët në trazirat e viteve 1997-1998, si dhe 13 debitorë në vlerën 8,477,624 lekë, për të cilët Garda e Republikës i ka marrë në ngarkim në kontabilitet për llogari të të tretëve. Pala e tretë në këto raste janë zyrtarë përmbartimorë dhe këta debitorë kanë të bëjnë me kredi të pakthyera bankave të nivelit të dytë dhe institucioneve financiare të ndryshme si dhe pensione ushqimore për fëmijët, familjet e të cilëve kanë bërë divorc.

-Në pasqyrat financiare të IKMT-së, vlera debitorë është 1,513,907,360 lekë, e cila përfaqëson gjobat e vendosura nga degët e ish Policisë së Ndërtimit gjatë periudhës 1994-2007 dhe arkëtimi i tyre ndiqej nga vetë Degët e Policisë së Ndërtimit, të cilat u shkrinë me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit" dhe ndarjen e kompetencave midis INUK dhe INUV. Po kështu qëndron debitor edhe gjobat e vendosura nga INUK dhe IKMT për periudhën 2008-2016 në vlerën 2,250,376,048 lekë si dhe vlera prej 5,070,209 lekë e cila përfaqëson detyrime të lëna nga auditimi në vite për ish-punonjësit e Policisë së Ndërtimit si dhe të INUK.

-Në DP Rezervave të Shtetit, paraqiten debitorë pa shpresë arkëtimi me vlerën 1,671,183,293 lekë, ku përfshihen llogaria 411-418 "klientë e llogari të ngjashme me to", të krijuar në trazirat e vitit 1997, në vlerën 243,576,635 lekë, dhe llogaria 423,429 "Personeli paradhënie deficite e gjoba", në vlerën 1,427,606,658 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 28-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

### **9. 1. Rekomandimi**

MB të marrë masa, duke krijuar grup pune të veçantë me përfaqësues të fushës së financave dhe fushës juridike për analizimin e hollësishëm të debitorëve. Të bashkëpunohet me Drejtorinë e Policive, me Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe me Gjendjen Civile, për gjetjen e saktë të të dhënave të debitorëve fizik (ish-punonjës) dhe të subjekteve fizik e juridik.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

*Brenda muajit qershor 2018*

### **9. 2. Rekomandimi**

Të dërgohen shkresa zyrtare për arkëtimin e detyrimeve, për debitor që janë me shpresë arkëtimi, ndërsa për debitorët që janë pa ndonjë shpresë arkëtimi, ti propozohet Ministrisë së Financave që ti mbajnë në llogaritë jashtë bilancit, ose të ndiqet procedurat ligjore për parashkrimin e tyre.

Afati për zbatimin e rekomandimit :

*Brenda muajit qershor 2018*

### 9.3. Rekomandimi:

Për subjektet private debitorë të dërgohen shkresa Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për të njoftuar për detyrimet që ato kanë ndër vite ndaj MB dhe të merren hapat bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve, për të mundësuar arkëtimin e këtyre detyrimeve.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

*Brenda muajit qershor 2018*

**10. Gjetja:** Ministria e Brendshme, në datën 13.03.2017 ka lidhur kontratë me subjektin privat “K...”, për dhënie me qira të objektit në katin përdhe të godinës së Ministrisë me sipërfaqe 52 m<sup>2</sup>, me afat përdorimi 1 vit, me destinacion lokal bar-bufë. Në nenin nr. 6, pika 6.1, të kontratës përcaktohet se: “*Qiramarrësi detyrohet të paguajë vlerën e energjisë elektrike dhe të ujit për çdo muaj, sipas konsumit faktik, në bazë të kontratave respektive të lidhura me UKT dhe OSHEE. Pagesat e vlerës për energjinë dhe ujin do të bëhet pranë UKT dhe OSHEE-së*”. Nga auditimi rezultoi se, ky nen i kontratës nuk është zbatuar, pasi Shoqëria “K...”, nuk ka kontratë dhe nuk ka lidhur aparat matës me UKT dhe OSHEE. Pagesat janë bërë në Degën e Thesarit Tiranë për llogari të MB. Këtë e kanë realizuar duke vendosur nga një nën sahat si për energjinë elektrike ashtu edhe për ujin dhe leximin e tyre e bëjnë vetë punonjësit e ministrisë. *Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 78, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

### 10.Rekomandimi:

Ministria e Brendshme të marri masat që qiramarrësi në zbatim të kushteve të kontratës së sipërcituar të lidhë kontratë me OSHEE dhe UKT për të vendosur matës energjie dhe matës uji.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

*Menjëherë*

**11. Gjetja:** Për pasurinë shtetërore, në pronësi të MB, i quajtur “Vend drejtimi kryesor i Ministrisë së Punëve të Brendshme (Objekti shtylla) me sipërfaqe 1.022 m<sup>2</sup>, në zbatim të VKM nr. 54, datë 5/2/2014 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, nëpërmjet procedurave të konkurrimit në datën 17.10.2016 ka lidhur kontratë qiraje me subjektin privat qendra “U..”. Ky objekt do të përdoret me destinacion për ngritjen e një ekspozite permanente multi funksionale, me afat përdorimi për një periudhë 20 vjet, dhe tarifë mujore në vlerën 61,400 lekë. Në këtë kontratë janë parashikuar që qiramarrësi duhet të bëjë investime në vlerën prej 2 milion lekë për 12 muaj për riparime të ndryshme strukturore, sistemi i ndriçimit të brendshëm, ngritja e impiantit audio dhe video, etj.. Gjithashtu është parashikuar që qiramarrësi do të punësojë 4 punonjës në objektin e marrë me qira. Për këto detyrime qiramarrësi në fillim të çdo viti duhet të bëjë një relacion me shkrim për vlerat e investimeve të regjistruara në pasqyrat financiare të shoqërisë të shoqëruara me relacionin e ekspertit kontabël si dhe të shoqëruar me vërtetimin nga institucionet shtetërore përkatëse për numrin e të punësuarve. Por, për monitorimin e zbatimit të kushteve të kësaj kontrate qiraje, MB nuk ka caktuar një punonjës përgjegjës, në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 5/2/2014 . *Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 79-80, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

### 11. Rekomandimi:

Ministria e Brendshme të marri masat që brenda strukturës organike të caktohet një punonjës për monitorimin e kësaj kontrate.

**12. Gjetjet.** Këshilli i Ministrave për çdo vit buxhetor, planifikon fonde për parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile, në mbështetje të ligjit Nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”. Për këtë qëllim në buxhetin e MPB, në programin “Emergjenca civile” në artikullin 604 “Transferta korentë të brendshme” për të tre vitet i janë akorduar fonde dhe transferuar përkatësisht, për vitin 2015 vlerën 754,739 mijë lekë; për vitin 2016, vlerën 581,582 mijë lekë dhe për tetë mujori e vitit 2017 vlerën 78,848 mijë lekë. Kjo mbështetje financiare për njësitë vendore është bërë për marrjen e masave parandaluese normale për rastet kur nuk është shpallur gjendja e emergjencës civile. Në lidhje me auditimin e dokumentacionit përkatës të sjellë nga njësitë e qeverisjes vendore për transferimin e fondeve për të financuar familjet dhe ndërtimin e infrastrukturës publike të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore, nga auditimi me zgjedhje u konstatuan këto parregullsi:

- Të gjitha kërkesat e njësive vendore për dëmshpërblimin e familjeve të dëmtuara nuk janë regjistruar në një regjistër të veçantë me të dhënat të detajuara;
  - DPEC nuk ka monitoruar dhe kontrolluar, mënyrën dhe shpërndarjen e fondit, nga ana e njësive vendore si dhe nuk ka asnjë informacion për vlerat financiare të shpërndara familjeve të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore. Të gjitha njësive vendore përfituese të fondit të dëmshpërblimit nuk u është kërkuar zyrtarisht, që të raportojnë dhe të dokumentojnë procesin e shpërndarjes së fondit familjeve të dëmtuara;
  - Përgatitja e dosjeve për të dhënë ndihma, ekzekutoheshin me shumë vonesa, ku u konstatuan raste të dëmtimeve të banesave të familjeve në vitin 2014 dhe shpërblimet jepeshin në vitet 2016-2017;
  - Në disa raste, kërkesat nuk kishin të cilësuar datën e ndodhjes së dëmtimit të banesave si dhe nuk kishin të cilësuar as dëmtimet e ndodhura konkrete e sidomos llojet e orendive shtëpiake apo pajisjeve elektronike;
  - Përgatitjet e preventivave të ndërtimit nuk janë cilësuar nëse i ka kryer specialist që është punësuar në pushtetin vendor apo është marrë nga jashtë, ku për preventivuesit e marrë nga jashtë duhej të ishin vendosur numri i licencës përkatës, duke i bashkëlidhur edhe fotokopje dokumenti.
  - Në disa raste mungonte dokumentacioni vërtetues i analizave të çmimeve të ndërtimit për ato zëra që nuk përfshihen në manualët përkatës të ndërtimit të miratuar me VKM.
  - Nuk kishte përlllogaritje, për rastet kur vlera e tregut të banesave është më e ulët se vlera e banesës e llogaritur mbi bazën e kostos së ndërtimit të banesave sipas EKB-së, me qëllim që të merrej për bazë vlera e tregut të lirë të rrethit/zyetit përkatës.
  - Vlerësimi për orenditë, mobiliet dhe pajisjet elektro shtëpiake të dëmtuara në objektet e banimit nuk kishte dokument vërtetues të çmimeve aktuale mesatare, të përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
  - Dosjet e vlerësimeve nuk janë shoqëruara me fondet e akorduara nga MF si dhe vlerësimet e bërë nuk janë shoqëruara me dokument sqarues, por janë punuar duke korrigjuar çmimet e vlerësimeve nga sipër me laps plumbi.
  - Për të gjitha rastet e ndërtimit të infrastrukturës DPEC nuk ka kryer verifikim dhe inspektim për ecurinë e punimeve dhe përfundimin e tyre.
- Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 81-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

## **12. Rekomandimi:**

Meqenëse Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, aktualisht ka kaluar në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, Ministria e Brendshme të njoftojë Ministrinë e Mbrojtjes për marrjen e këtyre masave:

### **12.1. Rekomandimi:**

Përgatitja e dosjeve për dhënie ndihme familjeve të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore të plotësohen me afate kohorë sa më të shkurtër.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

*Në vijimësi*

### **12.2. Rekomandimi:**

Vlerësimet e orendive shtëpiake të bëhen me dokument vërtetues të çmimeve aktuale mesatare, të përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Ndërsa për çmimet e preventivave të ndërtimit që nuk janë përcaktuar në manual teknik të çmimeve të miratuar me VKM, të përcaktohen dhe të shoqërohen me analizat përkatëse të çmimeve, të përgatitur nga specialistë të fushës nga vetë njësisë vendore dhe në mungesë nga specialist privat të licencuar.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

*Në vijimësi*

### **12.4. Rekomandimi:**

Për çdo rast të fondeve të transferuara në njësitë vendore për ndërtimin e infrastrukturës publike të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore, të kryhen inspektimit periodike me specialistë të fushës për ecurinë dhe përfundimin e punimeve dhe të dokumentohen me dokumentacion teknik të inspektimit përkatës

Afati për zbatimin e rekomandimit:

*Në vijimësi*

**13. Gjetje.** Në kundërshtim me, Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe me Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar nga Ministri i Financave (i ndryshuar), për periudhën e auditimit, MPB, nuk ka planin strategjik, për të reflektuar objektivat strategjike, për të reflektuar objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, të cilat janë në zbatim të strategjisë nder sektorialë. Mos hartimi i Planin Strategjik, në institucion ka shkaktuar mos rishikimin e vazhdueshëm të objektivave të programeve, aktiviteteve dhe projekteve, që duhet të realizohen përmes proceseve të punës. Sa më sipër gjithashtu ndikon në mos përcaktimin e qartë të proceseve të punës. *Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 97-106, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

### **13. Rekomandimi:**

MB të marrë masa për të hartuar Planin Strategjik, i cili duhet të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, për arritjen e qëllimeve strategjike, me persona konkretë përgjegjës për realizimin e tyre. Objektivat strategjike duhet të jenë të lidhura me planin financiar buxhetor përmes objektivave të përcaktuara në mënyrë të qartë për programet, projektet dhe aktivitetet.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

*Në vijimësi*

**14. Gjetje.** Veprimtarie e MPB, ka vijuar të funksionojë me rregulloren e brendshme të miratuar nga Ministri, me urdhrin nr. 146/1 datë 31.07.2013 “Miratimi i rregullores së brendshme të Ministrisë së Brendshme” edhe pse gjatë periudhës objekt auditimi, ka pasur ndryshime në strukturë si, krijimi i pozicioneve të reja apo sektorëve të rinj. Këto ndryshime vijnë të mos reflektohen në rregulloren e institucionit, në kundërshtim kjo me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe me

Manualin i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar nga Ministri i Financave. *Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 97-106, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**14.Rekomandimi:**

MB, të marrë masa për të reflektuar në Rregulloren e Brendshme, ndryshimet e ndodhura në strukturë, për të ndihmuar punonjësit e institucionit të kuptojnë marrëdhëniet ndërmjet strukturave administrative të veçanta, vendin që ato zënë në njësi, si dhe të njihen me te drejtat dhe detyrimet, të cilat i korrespondojnë pozicioneve të tyre.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

*Deri në muajin qershor 2018*

**15. Gjetje.** U konstatua se, gjatë periudhës objekt auditimi, edhe pse është ngritur GMS mungon dokumentimi i takimeve të realizuara apo problematikave të trajtuara, duke mos ofruar kështu siguri të arsyeshme mbi kryerjen ose jo të mbledhjeve të GMS-së, sipas kërkesave të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe me Manualin i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar nga Ministri i Financave. *Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 97-106, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**15. Rekomandimi:**

Nëpunësi autorizues, gjatë mbledhjeve të GMS, të marrë masa mbi dokumentimin e mbledhjeve, dhe çështjeve/problematikave të trajtuara nga anëtarët e grupit të GMS, me qëllim gjurmimin e vendimeve të marra përgjatë takimeve të grupit dhe ndjekjen e zbatimit e tyre.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

*Në vijimësi*

**16. Gjetje.** MPB, Në kundërshtim me, ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, nuk ka organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve, me qëllim njohjen dhe shkëmbimin e përvojave mbi praktikave të mira në fusha të ndryshme, edhe pse referuar listës së risqeve të evidentuara si prioritete për institucionin, “trajnimi i stafit” është renditur ndër faktorët e parë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 97-106, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**16. Rekomandimi:**

Strukturat përgjegjëse të MB, të marrin masat e duhura për parashikimin e nevojave për zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, dhe në bazë të këtyre parashikimeve të hartojnë dhe kryejnë trajnime specifike për punonjës të administratës mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualin e nxjerrë në zbatim të tij.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

*Në vijimësi*

**17. Gjetje.** Për periudhën korrik 2017 e në vazhdim, referuar organikës së miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 162 datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Brendshme”, ka mungesë me një punonjës në strukturën organike të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në MB. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 10, faqe 106-113, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**17. Rekomandimi:**

Strukturat përgjegjëse të MB të marrin masa të menjëhershme për plotësimin e organikës së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

*Në vijimësi*

**18. Gjetje.** Ka mungesë komunikimi dhe shkëmbim informacioni midis njësive audituese të MB, konkretisht, të sektorit të auditimit të Drejtorisë së Policisë së Shtetit, të sektorit të auditimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Shtetërore, me Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në MB. Nuk është kryer riorganizimi i njësive audituese të sistemit të MB, sipas kërkesave të dispozitave të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe Vendimit nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” i Këshillit të Ministrave i ndryshuar me Vendimin nr.353, datë 11.5.2016 "Për një ndryshim në VKM nr.83, date 03.02.2016. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 10, faqe 106-113, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**18. Rekomandimi:**

Ministria e Brendshme të kryejë riorganizimin dhe harmonizimin e strukturave të auditimit të të gjithë sistemit të MB, për të mundësuar sigurimin e cilësisë së auditimit të brendshëm,

Afati për zbatimin e rekomandimit:

*Në vijimësi*

**19. Gjetje.** Drejtoria e Auditimit të Brendshëm nuk është i informuar në kohën e duhur, për vendimet e rëndësishme që merren nga menaxhimi i lartë i njësisë publike (nuk ka asnjë ftesë për pjesëmarrje), në kundërshtim me nenin 27 “Takime periodike ndërmjet menaxherëve të njësisë së sektorit publik”, të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 10, faqe 106-113, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**19. Rekomandimi:**

Menaxhimi i lartë i njësive publike, të ftojë në mënyrë sistematike Drejtuesin e NJAB-së, për të marrë pjesë në takimet e organizuara për marrje vendimesh të rëndësishme.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

*Në vijimësi*

**20. Gjetje.** Praktikrat e auditimit të brendshëm, rezultojnë të inventarizuar, sipas kërkesave të parashikuara në “Normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Shkresat dhe/ose dokumentet që lidhen me të janë evidentuar me të njëjtin numër progresivisht me fraksion, deri në mbyllje të praktikës, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Por, praktikrat (dosjet) e auditimit që nga viti 2014 mbahen në zyrat e Drejtorisë së auditimit të Brendshëm dhe nuk janë arkivuar në protokoll arkivin e Ministrisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 10, faqe 106-113, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**20. Rekomandimi:**

Të kryhet arkivimi i dosjeve të përfunduara e të inventarizuara nga DAB, sipas kërkesave të ligjit nr.9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

**21. Gjetje.** Në buxhetin e vitit 2016 të MB, në programin e “Emergjencave Civile”, janë planifikuar 42,273,386 lekë. Ky fond është shpenzuar në shumën 41.862.532 lekë, për pagimin e shoqërisë “V. H.” (“Aq & V. I.”) e kontraktuar pa procedura prokurimi për kryerjen e shërbimit ajror të fikjes së zjarreve që kanë rënë në territorin e vendit në muajin gusht-shtator të këtij viti. Po kështu edhe në buxhetin e vitit 2017, të MB, në këtë program janë planifikuar 29,000,000 lekë. Ky fond është shpenzuar në shumën 27,318,750 lekë, përsëri për pagimin e shoqërisë “V. H.” (“A. & V. I.”) e kontraktuar pa procedura prokurimi, për kryerjen e shërbimit ajror të fikjes së zjarreve që kanë rënë gjatë muajit korrik-gusht të këtij viti.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm (DAB) në MPB, si për vitin 2016 dhe për vitin 2017 ka kryer auditim të hollësishëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile, pikërisht për “Procedurat e ndjekura për përbalimin e situatës së zjarreve të rëna në territorin e vendit”. Në këto auditime ka konstatuar një sërë shkeljesh ligjore të cilat i ka trajtuar hollësisht në raportet përfundimtarë të auditimeve. Për shkeljet e konstatuara në këto dy auditimin, janë rekomanduar një sërë masash për zbatim nga DPEC. Ndër rekomandimet me kryesore është që, ky shërbim për vitin 2017 dhe vitet në vijim të kontraktohet nëpërmjet realizimit të procedurave të prokurimit. Gjithashtu, në zbatim nenit 14, të ligjit 114 datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” që bënë fjalë për *“Raportimin menjëherë në formë të shkruar tek titullari i njësisë publike dhe te Ministri i Financave, i cili ka në varësi strukturën e inspektimit financiar publik, kur zbulon parregullsi apo veprime, që në vlerësimin e njësisë së auditimit përbëjnë vepër penale”*, të dy grupet e auditimit, i kanë kërkuar Ministrin të Brendshëm dhe Sekretarin të Përgjithshëm, që: t’i kërkohej Ministrisë së Financave, që të kryhej Inspektim Financiar për një shqyrtim të mëtejshëm administrativ mbi impaktet e mundshme financiare në buxhetin e shtetit lidhur me gjetjet e konstatuara nga këto auditime. Mirëpo, nga auditimi i KLSH-së në lidhje me zbatimin e këtyre rekomandimeve u konstatua se, rekomandimi i auditimit të vitit 2016 për kontraktimin e këtij shërbimi në vitin 2017 nëpërmjet procedurave të prokurimit, nuk është zbatuar nga DPEC. Po kështu edhe kërkesa për inspektim financiar nga Ministria e Financave për vitin 2016 nuk është dërguar nga strukturat drejtuese të MPB në këtë Ministri, ndërsa kërkesa për shkeljet e konstatuara në auditimin e vitit 2017 drejtuar Ministrisë së Financave për inspektim financiar është bërë nga Drejtori i Auditit të Brendshëm me nr. 4232/245, datë 24.11.2017. Por deri në momentin e hartimit të këtij Raporti Auditimi, Ministria e Financave nuk ka filluar inspektimin financiar për vlerësimin e shkeljeve dhe parregullsive të konstatuara nga auditimi i brendshëm për kryerjen e këtij shërbimi si, për vitin 2016 ashtu dhe për vitin 2017.

Nisur sa sipër, meqenëse, procedurat e kontraktimit të këtij shërbimi për të dy vitet janë audituar nga vetë MB dhe kjo ministri i ka kërkuar Ministrisë së Financës që këto shërbime të hetohet administrativisht nga inspektimi financiar, me qëllim shmangien e mbivendosjes së auditiveve dhe respektimin e integritetit institucional të Auditimit të Brendshëm dhe Inspektimit Financiar, KLSH, në referim dhe bazuar në Standardin Ndërkombëtar të Auditimit “ISSAI 1610” e cili lejon: *“Audituesin e jashtëm që të përdorë punën e auditimit të brendshëm për të modifikuar natyrën ose kohën, ose për të zvogëluar shkallën e procedurave të auditimit që duhet të kryhen drejtpërdrejt nga audituesi i jashtëm”*, merr të mirëqenë dhe mbështet konkluzionet e dy auditimeve të kryera nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm. (Më hollësisht trajtuar në pikën 10, faqe 113-117, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

### 21.1. Rekomandimi:

Meqenëse nga Ministria e Financave deri më sot, nuk ka filluar inspektimin financiar, Ministria e Brendshme, të ri përsërisë shkresën për Ministrinë e Financave dhe ti kërkoj kryerjen e Inspektimit Financiar për procedurat e ndjekura nga DPEC për përballimin e situatës së zjarreve të rëna në territorin e vendit gjatë vitit 2016 dhe 2017.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

*Menjëherë*

## **21.2. Rekomandimi:**

Meqenëse Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, ka kaluar në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, Ministria e Brendshme duhet ta njoh këtë Ministri me rezultatet e auditimit të brendshëm dhe në përfundim të inspektimit financiar dhe me rezultatet e këtij inspektimi, si dhe ti kërkojë që, për çdo vit, me miratimin e buxhetit të shtetit, të fillojnë procedurat e prokurimit, bazuar në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, për të mundësuar lidhjen e një marrëveshje kuadër për kontraktimin për gjatë gjithë vitit të shërbimit të shuarjes së zjarreve nga ajri.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**22. Gjetje:** Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, në vitin 2015, ka ushtruar auditim për veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC). Në raportin përfundimtar të këtij auditimi është trajtuar edhe zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme. Konkretisht, DAB në auditimin e kryer në vitin 2014, ka lënë për zbatim rekomandimin për arkëtimin e shumës 216,653 mijë lekë. Nga verifikimi i bërë mbi arsyet e krijimit të kësaj vlere debitorë sipas raporteve të auditimit, rezultoi se: në vitin 2009, nga buxheti i shtetit ishin kryer financimi në vlerën 216,653 mijë lekë për “Postën Shqiptare sha”, me fondet e programit buxhetor të DPGJC. Ky financim është kryer në zbatim të VKM nr.419, datë 30.04.2009 “Për procedurat e pajisjes së shtetasve pa pasaportë, që nuk përfitojnë kompensim nga VKM nr.366, datë 15.04.2009 “Për kompensimin e pagesës për pajisjen me letërnjoftim të shtetasve në nevojë” dhe të Udhëzimit të MF nr.28, datë 04.05.2009 “Për rregullat e hollësishme dhe mënyrën e pagesës së “Posta Shqiptare sha” për çmimin e letërnjoftimit”. Sipas kësaj baze ligjore 216.653 shtetas do të rimbursohen nga buxheti me çmimin 1,000 lekë, gjithsej në vlerën 216,653 mijë lekë. Sipas Udhëzimit të sipërcituar brenda gjashtë muajve nga data e dhënies së kësaj vlere nga buxheti i DPGJC, “Posta Shqiptare sha”, duhej të bënte mbledhjen nga shtetasit të vlerës së dhënë dhe të bënte arkëtimin e kësaj për llogari të buxhetit. Pra për 216.653 shtetas, buxheti i shtetit fillimisht ka financuar diferencën prej 1,000 në vlerën totale 216,653 mijë lekë, të cilën do ta merrte mbrapsht, mbasi të mblidhej nga Posta Shqiptare brenda 6 muajve, veprim ky që nuk është kryer nga Posta Shqiptare. Për këto DAB ka lënë rekomandimin që:

- Nga DPGJC, të ndiqen hapat ligjorë për gjetjen e listave të personave që kanë aplikuar në zbatim të këtij Vendimi, për të cilët është bërë pagesa nga buxheti i shtetit në vlerën 216,653 mijë lekë. Të bëhet rakordimi me “Postën Shqiptare sha” mbi detyrimet për listën e personave aplikues dhe të arkëtohet vlera nga këto persona për llogari të buxhetit të shtetit.

Deri në përfundim të auditimit të vitit 2015 të kryer nga DAB, DPGJC nuk kishte ndërmarrë asnjë hap për zbatimin e këtij rekomandimi. Për këtë arsye nga DAB, në auditimin e vitit 2015 ka lënë përsëri të njëjtin rekomandim. Mbas këtij rekomandimi, DPGJC i ka dërguar tre shkresa Postës Shqiptare duke i kërkuar listën me emrat e shtetasve që kanë marrë financimi prej 1,000 lekë secili. Posta Shqiptare, ka kthyer përgjigje dhe ka informuar se, nuk disponon lista me emrat e shtetasve debitor. Pra deri në momentin e këtij auditimi, ende nuk është bërë

arkëtimi në buxhetin e shtetit të shumës 216,653 mijë lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 10, faqe 117-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

## 22. Rekomandim:

Ministra e Brendshme, në bashkëpunim me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë dhe me Postën Shqiptare sh.a., të marrin iniciativën ligjore për të propozuar Këshillit të Ministrave, ngritjen e një grupi të posaçëm pune për të analizuar gjendjen dhe marrjen e masave për mundësimin e arkëtimit të kësaj vlere, apo parashkrimin (shuarjen) e këtij detyrimi.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

*Menjëherë*

## C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

**1. Gjetje.** MB, për nevoja e funksionimit të sistemit dhe të kryerjes së shërbimeve për Gjendjen Civile ka pasur në zbatim si dhe ka lidhur një sërë kontratash me operatorët privat, konkretisht:

-Kontrata e lidhur me subjektin “X.S A” Austri, në datën 31.12.2014 “Për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile”, me afat deri në 31.12.2017, me një vlerë totale 309,893,592 lekë dhe deri në 30.11.2017 për shërbimin e kryer janë paguar me këste mujore gjithsej 309,893,592 lekë, me TVSH;

-Kontrata e lidhur me subjektin “I...”, në datën 12.10.2015, për “Ndërtimin e sistemit Site-it Disaster Recovery” dhe “Suport/mirëmbajtje e infrastrukturës së sistemit të Gjendjes Civile për në sitin primar të Qendrës së vazhdueshmërisë së punës”, me afat deri në datën 11.03.2019, me vlerë totale 214,513,006 lekë dhe deri në 31.12.2017 për shërbimin e kryer janë paguar gjithsej 153,224,686 lekë;

-Kontrata e lidhur me subjektin “F...” në datën 29.12.2015 për “Ndërtimin e sistemit funksional online të adresave” dhe “Suport dhe mirëmbajtje e sistemit”, me afat deri në 25.03.2020 me vlerë totale 175,460,000 lekë dhe deri në 31.12.2017 për këtë shërbim janë paguar gjithsej 144,756,000 lekë;

-Kontrata e lidhur me subjektin “I...”, në datën 30.09.2016 për “Ndërtimin e dhomës së infrastrukturës së ICT të DPGJC” dhe “Shërbime mirëmbajtje” me afat deri në 31.12.2020 në shumën totale 26,208,000 lekë dhe deri në 31.12.2017 për shërbimin e kryer janë paguar gjithsej 19,008,000 lekë;

-Kontrata e lidhur me subjektin “I...”, në datën 28.12.2016 për “Ndërtimin e ndërfaqes së komunikimit” dhe “Shërbime mirëmbajtje” me afat deri në datën 28.01.2021 në vlerën totale 61,614,342 lekë dhe deri në 31.12.2017 janë paguar 52,974,342 lekë. Po me këtë subjekt, në datën 15.03.2017 është lidhur kontratë tjetër për “Shërbime mirëmbajtje dhe zhvillim të mëtejshëm i portalit të RJGJC” me afate deri në datën 13.03.2020 në vlerën totale 28,794,265 lekë dhe deri në 31.12.2017 janë paguar për këtë shërbim gjithsej 9,065,570 lekë;

-Kontrata e lidhur me subjektin “A...” në datën 16.03.2017 për “Shërbimin e rrjetit të komunikimit online të GJC” me afat deri në datën 30.09.2019 (shtyrë dy herë), me vlerë totale 233,847,928 lekë dhe deri në 31.12.2017 për këto kontrata janë paguar gjithsej 228,074,858 lekë;

-Me VKM Nr. 207, datë 16.03.2016, është ngarkuar OSHEE sh.a. si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurës së prokurimit publik për llogari të vet dhe të MPB, për projektin “Ndërtimi i një sistemi funksional adresash”. Në zbatim të këtij vendimi, OSHEE sh.a., ka prokuruar fondin limit, të llogaritur si, shumë e fondeve të veta (nga të ardhurat e saj) dhe fondit buxhetor të miratuar për vitin 2016, për MPB në, programi buxhetor “Shërbimi i Gjendjes Civile” në vlerën 400,000,000 lekë. Nga OSHEE është lidhur në datën 29.09.2016 kontrata

me bashkimin e operatoreve “C. P.& D.& Ç. .” me vlerë 1,019,496,000 lekë me TVSH. Menjëherë mbas lidhjes së kontratës, në zbatim të VKM, së sipërcituara, MPB me urdhër shpenzimin nr. 383, datë 12.10.2016 ka kryer transferimin e shumës 400,000,000 lekë, në favor të OSHEE.

Përveç projektit “Ndërtimi i një sistemi funksional adresash” që është realizuar nga OSHEE, procedurat e prokurimit për të gjitha këto shërbime, por edhe për mallra dhe punë për nevoja të vetë MB, janë realizuar nga Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara (DPP) e cila është në varësi të kësaj Ministrie. DPP, për këtë periudhë auditimi është audituar më parë nga KLSH. Po kështu edhe cilësia e shërbimeve në zbatim të këtyre kontratave, aktualisht po auditohet nga një grup audituesish nga Departamenti i IT të KLSH. Në këto kushte, auditimi mbi zbatimin e këtyre kontratave u përqendrua vetëm në dokumentacionin justifikues bashkëlidhur pagesave të këtyre shërbimeve, dhe në përgjithësi, u vërejte se, në të gjitha rastet e pagesave për shërbimet e kryera ishte bashkëlidhur dokumentacioni justifikues. Por në veçanti për kontratën me subjektin “**X.S A” Austri**, për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile, u konstatua se: MB, për shërbimin e kryer deri në nëntor 2017 ka paguar subjektin “X.S.A”, direkt në llogarinë e tij në Austri, në vlerën totale 258,244,662 lekë, pa TVSH dhe njëkohësisht ka paguar për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve vlerën e TVSH në total prej 51,648,930 lekë. Pagesa e TVSH për çdo rast është bërë duke prerë auto faturë TVSH-je. Këto veprime bien në kundërshtim me, ligjin nr. 9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar dhe me udhëzimin e MF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, sepse sipas kësaj baze ligjore, vetëm përfaqësues tatimor i subjektit, ka të drejtën të dorëzojë deklaratat e TVSH-së në Shqipëri në emër të personit që përfaqëson, si dhe deklarata të tjera tatimore kur ato i kërkojnë nga legjislacioni tatimor në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ndërsa ky subjekti është jo rezidentë dhe nuk ka të emëruar si përfaqësues tatimor një tatimpagues shqiptar, të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) si dhe vetë kjo shoqëri nuk është regjistruar në QKB. Mos regjistrimi i kësaj shoqërie në QKB apo mos regjistrimi i përfaqësuesit tatimor si dhe faturimi i TVSH-së me auto faturë, në kundërshtim me bazën ligjore të sipërcituar, **ka sjell shmangien e tatimit në burim nga subjekti “X.S A”, për pasojë nuk është derdhur në buxhetin e shtetit tatimi në burim në vlerën totale 38,244,662 lekë, për periudhën tatimore 2015, 2016 dhe 2017.**

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 18-19, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

### **1. Rekomandimi:**

Ministria e Brendshme të njoftoj dhe të bashkëpunoj me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për të llogaritur saktësisht tatimin në burim dhe të filloj procedurat ligjore e administrative për kërkimin, ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimit nga subjekti “X.S.A” të shumës rreth 38,244,662 lekë.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Menjëherë**

**2. Gjetje.** MB, mbas realizimit të procedurave të prokurimit nga DPP, në datën 11.08.2015, ka lidhur kontratën operatorit ekonomik "F...." për “**Restaurim i Godinës së Ministrisë së Punëve të Brendshme**”, me vlerë 272,598,931 lekë me TVSH me afat deri në datë 31.12.2015. Në datën 24.06.2016, është lidhur kontratë tjetër për punimet shtesë të godinës, nga 1 kat në 3 kat, me vlerë 54,494,594.8 lekë me TVSH ose në masën 19.9 % të kontratës fillestare, me afat 45 ditë kalendarike. Nga auditimi mbi verifikimin e zbatimit të punimeve, u konstatua se, zëri i punës “Furnizim Vendorsje, Parket Druri” në sasinë 170 m<sup>2</sup>, me vlerë 1,122,000 lekë me TVSH, i parashikuar për tu vendosur në ambientet Ministrisë, është

situacionuar dhe është paguar në favor të këtij sipërmarrësi. Mirëpo, në datën datë 23.06.2016 MB, ka lidhur kontratë me operatorin fitues "E...." për "Blerje pajisje zyre për Aparatin e Ministrisë së Punëve të Brendshme" me vlerë 77,584,500 lekë. Në zbatim të kësaj kontrate, subjekti "E....", përveç furnizimit e pajisjeve dhe mobilieve, ka kryer "Furnizimin dhe Vendosje e Parketit" me vlerë 3,745,440 lekë, më përpara se, ky zë të situacionohej nga shoqëria "F....". Pra, zëri i "Furnizim Vendosje Parket Druri" në sasinë 170 m<sup>2</sup>, nuk është kryer nga sipërmarrësi "F" por është kryer nga subjekti "E..". Për pasojë subjekti "F...." është paguar padrejtësisht për këtë zë, duke i shkaktuar buxhetit të shteti dëm ekonomik në vlerën **1,122,000 lekë**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 55-67, të Raportit Përfundimtar të Auditmit)

## **2. Rekomandimi:**

MB, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërbllimin e këtij dëmi në **shumën 1,122,000 lekë**, nga sipërmarrësi i punimeve.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

*Menjëherë*

## **Ç. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE:**

**1. Gjetje.** Siç u trajtua dhe më lartë, MB ka lidhur kontratën me operatorit ekonomik "F...." për "**Restaurim i Godinës së Ministrisë së Punëve të Brendshme**", me vlerë 272,598,931 lekë dhe shtesën e kontratës me vlerë 54,494,594.8 lekë me TVSH. Nga auditimi mbi verifikimin e zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, specifikimet teknike, preventivin e punimeve dhe dosjes teknike për të dy këto kontrata u konstatuan, mbivendosje dhe mos rakordime në shtesa dhe pikësime në disa zëra dhe volume pune në vlerën totale 6,482,430 lekë, me TVSH, duke rritur kështu koston e këtij objekti dhe përdorimin e këtyre fonde buxhetore pa efektivitet dhe pa ekonomikitet. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 55-67, të Raportit Përfundimtar të Auditmit)

### **1.Rekomandimi:**

MB, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet dhe ekonomikitet të fondet buxhetore **në vlerën 6,482,430 lekë**

Afati për zbatimin e rekomandimit:

*Menjëherë*

**2. Gjetje.** Gjatë zbatimit të punimeve, për "**Restaurim i Godinës së Ministrisë së Punëve të Brendshme**", me vlerë 272,598,931 lekë nga, sipërmarrësi ("F...." ), mbikëqyrësi i punimeve dhe nga Autoriteti Kontraktor, u vërejt cedim dhe dëmtim i soletës së tarracës së katit të dytë të objektit ekzistues. Mbas projektit për vlerësimin konstruktiv të realizuar nga shoqëria "A. C.", përforcimi i soletës duhej të shoqërohej me punime shtesë në vlerën 14,800,377 lekë. Kështu, pas realizimit të procedurave të prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të kontratës për shkak të emergjencës së godinës, në datën 31.08.2016 me operatorit ekonomik

"Fusha" është lidhur kontratë shtesë për "Rikonstrukcionin e Tarracës së Ministrisë së Punëve të Brendshme", në vlerën **14,012,643 lekë me TVSH** me afat 45 ditë kalendarike. Nga auditimi u konstatua se, ky dëmtim ka ndodhur për arsye të rikonstrukcionit disa herë të tarracës, në vitet e mëparshme, por në projektin e zbatimit fillestar për **restaurimin e godinës** nuk janë marrë në konsideratë këto punime nga hartuesit e projektit, për pasojë kemi rritje të kostos së këtij objekti dhe përdormi pa efektivitet dhe pa ekonomicitet të fondeve shtesë për rindërtimin e kësaj tarrace **në vlerën 14,012,643 lekë**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 55-67, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

## **2. Rekomandim**

MB, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomicitet fondet publike **në vlerën 14,012,643 lekë**.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Menjëherë**

## **D. MASA DISIPLINORE E ADMINISTRATIVE**

Mbështetur në nenin 58 "Llojet e masave disiplinore", nenin 59 "Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore" të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil" dhe VKM nr. 171, datë 26.3.2014 "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil" dhe në mbështetje të Kreu III-të "Sanksionet" të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" i ndryshuar, i rekomandojmë Ministrinë Brendshme:

Të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësive për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, dhe të kërkojë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore e administrative.

## **E. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE**

**E.1.** KLSH do të ndjek me vëmendje të veçantë dhe vlerësojë marrjen e masave, që do të marrë Ministria e Brendshme për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga auditimi i kryer, reflektimin e tyre në përmirësimin sa më mirë të përdorimit të fondeve buxhetore në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit.

**E.2.** Për shkeljet e konstatuara në kontraktimin e shërbimit të shuarjeve të zjarreve nga ajri për vitin 2016 dhe 2017, të trajtuar në faqen 14-15 të këtij vendimi, KLSH do të rekomandojë Ministrisë së Financave që të fillojë menjëherë inspektimi financiar për vlerësimin e shkeljeve dhe parregullsisive të procedurave të ndjekura nga DPEC për përballimin e situatës së zjarreve të rena në territorin e vendit gjatë vitit 2016 dhe 2017.

KLSH do të do të ndjek me vëmendje, rezultatet dhe konkluzionet e këtij inspektimi financiar dhe në përfundim të afateve të përcaktuara në rekomandimet e lëna në këtë auditim dhe afatin e caktuar 6 muaj, në nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Ministria e Financave dhe Ministria e Brendshme duhet të përcjellin në KLSH, rezultatet dhe konkluzionet e këtij inspektimi financiar.

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendror dhe Drejtoria Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Zbatimit të Standardeve.*

**Bujar LESKAJ**

**KRYETAR**

TPZNAJ